

VENDIM
Nr.617, datë 21.12.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.194, DATË 22.4.1999 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, në pikën 2, paragrafi i “Paga e grupit, sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës”, bëhet:

- Paga e grupit II “2” –Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike
- Diplomë mbi shkollën e mesme

Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike të njihen të gjitha diplomat që japin titullin “Mësuesi i shkollës fillore”.

2.Efektet ekonomike të përballohen me buxhetin e planifikuar për vitin 2000, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi paas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.1.2000.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta